



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

# **Plani i Integruar i Ministrisë 2010**

Nëntor 2010



### Mesazhi i Ministrit

Viti 2010 do të jetë viti i rezultateve në rritje, që rrjedhin nga zbatimi i një programi qeveritar ambicioz në fushën e arsimit dhe të shkencës. Plani i integruar reflekton një vizion të plotë dhe një angazhim serioz të sistemit, për thellimin dhe konsolidimin e reformës së nisur, me qëllim arritjen e standarteve të Bashkimit Europian në arsim. Arsimi i standarteve Europiane i paraprin Shqipërisë Europiane.

Objektivi themelor i planit është krijimi i mundësive reale të arsimit për këdo dhe kudo. Cdo fëmijë, nxënës e student, pa asnjë dallim, meriton të shkollohet. Reforma dhe programet për 2010, e krijojnë këtë mundësi, për të gjithë territorin e vendit. **Cilësia** e arsimit është sfida që ia vlen të përballemi. Cilësia është, në fakt, sfida më afatgjatë në sistemin tonë arsimor. Për të përmirësuar cilësinë do të punohet në disa drejtime njëherësh. Reformimi i kurikulave në të gjitha nivelet me qëllim përshtatje me realitetin ekonomik e shoqëror të vendit dhe standartet europiane. Kualifikimi i vazhdueshëm i mësuesve dhe pedagogëve, është një nga përcaktuesit për cilësinë, që do të realizohet nëpërmjet programeve mbështetëse për zhvillimin e burimeve njerzore në arsim. Gjithashtu programi *Brain Gain* dhe *Fondi i Ekselencës* do të vazhdojnë të freskojnë Universitetet me eksperiencën amerikane e europiane. Tani është koha për fazën e dytë të shtrirjes së IT-së; implementimin dhe përdorjen e gjërë të teknologjisë në mësimdhënie dhe në menaxhimin e gjithë sistemit arsimor.

**Arsimi Profesional** përbën fokusin tjetër të rëndësishëm të Planit 2010. Bashkëpunimi me partnerë të huaj, mobilizimi i të gjitha kapaciteteve të nevojshme institucionale, do të sjellë zhvillimin e një sistemi modern të arsimit profesional. Krijimi i paketës nxitëse, që përfshinë bursa për shkollim dhe fonde për vetëpunsim pas mbarimit të shkollës, nxit interesin për arsimin profesional dhe krijon mundësinë për bashkëpunim me qeverisjen vendore dhe komunitetin. Zhvillimit të arsimit profesional privat do ti jepet përparësi.

**Reforma në Arsimin e Lartë** do të thellohet si reflektim ndaj realitetit; rritja e nevojës për shkollim krijon dhe nxit nevojën për partneritet mes sektorit publik dhe atij privat në arsim. 1) Në kuadrin e rritjes së autonomisë së Universiteteve do të reformohet sistemi i financimit të institucioneve të arsimit të lartë. 2) Arsimi i lartë privat do të zhvillohet dhe do të monitorohet me përparësi cilësia e tij. 3) Fondi i veçantë për kërkimin shkencor do të ketë synimin specifik për t'u aplikuar konkretisht në zhvillimin ekonomik të vendit. Programe të posaçme për inkurajimin e ekselencës në sektorin publik, duke bashkëpunuar me sektorin privat do të bëjnë të mundur një dinamizëm të sistemit arsimor.

Sistemi ynë arsimor është dhe do vazhdojë të reformohet në mënyrë që t'i shërbejë zhvillimit të vendit. Edukimi është aspekti më i rëndësishëm që influencon të tashmen; cdo familje shqiptare është drejtperdrejt e prekur nga sistemi arsimor. Edukimi influencon të ardhmen; visioni që formojmë sot në shkollë, do të reflektojë çka shoqëria jonë do të jetë në të ardhmen.

Myqerem TAFAJ

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

## Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë .....	4
2	Dokumentet strategjike të Ministrisë .....	5
3	Programet buxhetore të Ministrisë .....	8
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2010.....	10
5	Plani i Monitorimit i Ministrisë .....	16
Aneks 1	Programi i përgjithshëm analitik i projektakteve për vitin 2010 .....	17
Aneks 2	Rezultate që lidhen me Integrimin Evropian.....	23
Aneks 3	Investimet publike .....	23
Aneks 4	Projekte të ndihmës së huaj .....	26
Aneks 5	Plani i veprimit antikorrupsion për vitin 2010 .....	27

# 1 Misioni i Ministrisë

Sistemi arsimor synon formimin e aftësive individuale, për të përfituar dije e për t'i përdorur ato në interes të individit e të shoqërisë. Politikat e programit të arsimit dhe kërkimit shkencor hartohen nën objektivin e sigurimit të një sistemi arsimor cilësor, të integruar me kërkimin shkencor, që mundëson shanse të barabarta për të gjithë shtetasit dhe fokusohet në formimin e qytetarit me njohuritë e nevojshme për t'u përballur me kërkesat e ekonomisë së tregut, në përputhje me prioritetet kombëtare dhe ato europiane.

## ***Sfida aktuale e sistemit arsimor në Shqipëri është:***

***Përmirësimi i treguesve sasiorë e cilësorë të arsimit, për të arritur treguesit mesatarë të Bashkimit Evropian.*** Ky objektivi do të arrihet përmes;

- Rritjes së shpenzimeve në arsimin publik dhe inkurajimit të arsimit privat,
- Masivizimit të arsimit dhe zgjerimit të pjesëmarrjes në arsimin e mesëm, profesional dhe universitar,
- Rritjes së cilësisë së arsimit duke realizuar një arsimim në funksion të shoqërisë demokratike, tregut, punësimit dhe qytetarisë evropiane,
- Përmirësimit të drejtimit dhe monitorimit të të gjithë sistemit arsimor të vendit.

## ***Misioni i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës është të sigurojë:***

- Edukimin e vlerave demokratike e kombëtare dhe zotërimin e njohurive dhe shprehive për ekonominë moderne të tregut;
- Arsim të mbështetur në të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të fëmijëve në veçanti;
- Barazi të shanseve për arsimim për të gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë;
- Arsimim bazë për të gjithë;
- Cilësi në rritje për arsimin publik dhe privat në të gjitha nivelet;
- Arsim cilësor sipas nevojave dhe interesave të individit, komunitetit dhe shoqërisë në përgjithësi e sipas standardeve evropiane;
- Përshtatshmërinë e sistemit arsimor ndaj ndryshimeve;
- Mekanizmat e përgjegjshmërisë së shërbimit arsimor ndaj shoqërisë civile në tërësi;
- Efektivitetin e administratës arsimore qendrore dhe të njësive të saj vartëse;
- Efektivitetin dhe efikasitetin e burimeve njerëzore në arsim;
- Maksimizimin, efektivitetin dhe efikasitetin e burimeve financiare dhe materiale në arsim;
- Transparencën e shërbimit arsimor në të gjitha nivelet.

## 2 Dokumentet strategjike të Ministrisë

Programi i OKB-së, “Objektivat Zhvillimorë të Mijëvjeçarit”, që synon arritjen e objektivave të miratuara të mijëvjeçarit në nivel ndërkombëtar. Në zbatim të tij Programi i “Arsimit për të Gjithë” “EFA” .

**Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007 - 2013**, e cila kristalizon qartë vizionin afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit të vendit, bazuar në një proces të hapur e transparent, që synon kthimin e vendit tonë në një vend me nivel të lartë jetese, të integruar në strukturat europiane dhe euro-atlantike, demokratik dhe garant të lirive e të drejtave themelore të njeriut.

Përparësitë strategjike të sektorit të arsimit parauniversitar janë si më poshtë:

Reformimi dhe fuqizimi i kapacitetit politikëbërës, menaxhues dhe vendimmarrës;

Përmirësimi i cilësisë së procesit mësimor;

Përmirësimi i frytshmërisë së financimit në arsim;

Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i burimeve njerëzore;

Zhvillimi i arsimit profesional dhe i atij parashkollor;

Përparësitë strategjike në arsimin e lartë janë si më poshtë:

Rritja e përqindjes së grupmohës së studentëve në arsimin e lartë;

Ristrukturim më efikas i misioneve të formimit universitar në ciklet e ndryshme të studimit;

Sigurimi i një sistemi efektiv të sigurimit të cilësisë dhe akreditimit;

Rritja e nivelit të autonomisë institucionale;

Integrim më i mirë i mësimdhënies me punën kërkimore;

Përmirësimi i mësimdhënies;

Përmirësimi i financimit.

**Marrëveshja e Stabilizim - Asociimit dhe Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit**, synon integrimin evropian të Shqipërisë. Në fushën e arsimit kërkohet; Arsimi dhe Kërkimi Shkencor në Shqipëri të ngrihen në nivel partneriteti me BE, duke synuar arritjen e standardeve përkatëse.

### I. Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar

Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar 2009 - 2013, miratuar me Vendimin nr.799, datë 22.07.2009 të Këshillit të Ministrave, shërben si një platforme kombëtare sektoriale.

Kjo Strategji synon të garantojë një sistem arsimor kombëtar të standarteve europiane, i cili nxit rritjen e qëndrueshme ekonomike, konsolidimin e demokracisë dhe suksesin në dialogun dhe konkurrencën me vendet e rajonit e më gjerë.

Objektivat dhe qëllimet e kësaj strategjie janë:

- Ngritja e një sistemi arsimor kombëtar të standarteve europiane;
- Decentralizimi i vendimmarrjes së shërbimit arsimor;
- Rritja e autonomisë së shkollave, deri në nivelin e menaxhimit mbi bazë shkolle;
- Reformimi i sistemit të financimit dhe rritja e kapaciteteve përkatëse në të gjitha nivelet;
- Përdorimi i sistemit të menaxhimit të informacionit (EMIS) në procesin e vendimmarrjes në shërbimin arsimor;
- Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore, nëpërmjet rritjes së motivimit të mësuesve dhe trajnimit e kualifikimit të tyre;
- Përmirësimi dhe racionalizimi i infrastrukturës së shërbimit arsimor;
- Përmirësimi i mjediseve shkollore, krijimi i kushteve optimale mësimore dhe pajisja e shkollave me laboratorë e mjete didaktike dhe pajisje të nevojshme shkollore;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve për arsimimin e shtresave të marginalizuara;
- Rritja e viteve të shkollimit të popullsisë, me synim për të arritur në 11.2 vite shkollimi, deri në vitin 2015;
- Rritja e raportit të regjistrimit neto (NER) në 96% të nxënësve që frekuentojnë arsimin bazë deri në 2015;
- Zhvillimi sasior dhe cilësor i arsimit parashkollor. Përgatitja cilësore e vitit përgatitor të detyrueshëm;
- Rritja e përqindjes së fëmijëve që frekuentojnë arsimin parashkollor, për të arritur në masën 59% të grupmoshës në vitin 2010;
- Rritja e rezultateve të shkollimit, nëpërmjet zbatimit të standardeve të përmbajtjes dhe të arritjes;
- Matja e performancës së sistemit arsimor nëpërmjet vlerësimeve;
- Rritja mbi 10% e rregjistrimeve në shkollat e Arsimit të Mesëm Profesional;
- Zhvillimi dhe fuqizimi i arsimit profesional dhe social-kulturor në varësi të nevojave të tregut të punës;
- Futja e sistemit të kualifikimit të parapunësimit për specialistët e arsimit profesional dhe social-kulturor.

## **II. Strategjia Kombëtare e Arsimit të Lartë (AL) 2008-2013, miratuar me Vendimin nr.1509 datë 30.07.2008**

Objektivat dhe qëllimet e kësaj strategjie janë:

Zgjerimi i sistemit, në mënyrë që të plotësohen nevojat e vendit, duke krijuar njëkohësisht mundësi për arsimim të lartë të të gjithë atyre që dëshirojnë të përfitojnë prej tij;

Sigurimi i shumëllojshmërisë së ofertave të formimit, në përputhje me nevojat e zhvillimit perspektiv të vendit;

Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe të përvetësimit të dijeve në sistemin e AL, nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe të kulturës së cilësisë;

Përmirësimi i mekanizmave të qeverisjes nëpërmjet zhvillimit të autonomisë së institucioneve të AL, përkundrejt rritjes së cilësisë së menaxhimit me llogaridhënie dhe transparencë, në mënyrë që ato të funksionojnë realisht si institucione publike;

Përshtatja e metodave dhe e niveleve të financimit, në mënyrë që të inkurajohet i tërë sistemi për arritjen e objektivave të përgjithshme;

Rritja e numrit të studentëve në tre ciklet e studimit në masën 15%, në raport me vitin paraardhës;

Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) të plotësojnë më mirë nevojat e tyre akademike e kërkimore, nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare;

Përmirësimi i skemës dhe efektiviteti i mobilitetit të studenteve dhe i personelit akademik;

Integrimi sa më i shpejtë i të diplomuarve në tregun vendas dhe global të punës, nëpërmjet reformës në kurrikul, ECTS(European Credits Transfer System), si dhe të dhënave shoqëruese të Supplementit të Diplomës;

Rritja e cilësisë së studimeve Master dhe Doktoraturë, si edhe krijimi i kushteve për shtrirjen e studimeve Master në ato Shkolla të Larta ku garantohen standardet akademike;

Njohja e të gjitha formave të studimit nëpërmjet procedurave standarde dhe institucionalizimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve;

**III. Strategjia Kombëtare e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit 2009-2015**, miratuar me Vendimin nr.863 datë 29.07.2009 të Këshillit të Ministrave, e cila sjell edhe një dimension të ri, atë të inovacionit në Shqipëri.

Kjo strategji synon kryesisht :

1. Përmirësimin e infrastrukturës bazë të kërkimit, për të mbështetur formimin universitar në të tri nivelet e tij (BSc, MSc, PhD);
2. Krijimin e ekselencës shkencore në fushat kërkimore më të rëndësishme për vendin;
3. Formimin dhe mbajtjen/tërheqjen e njerëzve të kualifikuar në sistemin shqiptar të kërkimit shkencor;
4. Sigurimin e një mbështetjeje sistematike për inovacionin dhe transferimin e teknologjisë, për t'ju përgjigjur nevojave të sektorit prodhues.

## **3 Programet buxhetore të Ministrisë**

### **3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM**

**Qëllimet e Politikës së Programit:**

- Përmirësimi i skemës së Menaxhimit dhe Planifikimit, në përputhje me standardet bashkëkohore në shërbim të decentralizimit të shërbimit arsimor dhe rritjes së autonomisë së shkollave, duke përmirësuar e racionalizuar gjithë infrastrukturën e shërbimit arsimor;
- Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore brenda sektorit, si dhe përditësimi e menaxhimi i sistemit të informacionit në sektor.

### **3.2 ARSIMI BAZË (PËRFSHIRË PARASHKOLLORIN)**

**Qëllimet e Politikës së Programit:**

- Sigurimi i një shërbimi cilësor arsimor për të gjithë;
- Përfshirja e të gjithë 5-6 vjeçarëve në arsimin e detyruar;
- Përmirësimi i cilësisë së arsimit, nëpërmjet kurrikulave e teksteve cilësore, mësuesve të motivuar, përmirësimit të kushteve të mësimin, duke arritur raporte optimale mësues / nxënës, mësues / klasë dhe nxënës / klasë;
- Promovimi i iniciativës kundër varfërisë, për të zvogëluar hendekun në arsimin ndërmjet shtresave të ndryshme të popullsisë, duke rritur raportin e regjistrimit neto (NER) nga 94% në 96% në arsimin bazë deri në 2015.

### **3.3 ARSIMI I MESËM (I PËRGJITHSHËM)**

**Qëllimet e Politikës së Programit:**

- Shtrirja dhe zgjerimi i arsimit të mesëm të përgjithshëm, duke rritur numrin e tërheqjes së nxënësve që mbarojnë arsimin bazë në arsimin e mesëm të përgjithshëm;
- Përmirësimi i kurrikulës shkollore dhe metodave të mësimdhënies dhe rritja e cilësisë në funksion të përgatitjes së qytetarëve për tu përballur me sfidat e ekonomisë së tregut.
- Sigurimi i kushteve optimale për mësim;

### **3.4 ARSIMI I MESËM (PROFESIONAL)**

**Qëllimet e Politikës së Programit:**

- Rritja e tërheqjes së nxënësve që mbarojnë arsimin bazë drejt një arsimit të mesëm profesional;
- Rritja e cilësisë së ofertës mësimore dhe cilësisë së përgatitjes;



- Oferta e degëve dhe profesioneve të përputhet me kërkesat e tregut të punës, nëpërmjet përfshirjes së biznesit në hartimin e kurrikulave dhe realizimin e praktikave mësimore.

### **3.5 ARSIMI UNIVERSITAR**

#### **Qëllimet e Politikës së Programit:**

- Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe të përvetësimit të dijeve në sistemin e arsimit të lartë, nëpërmjet përmirësimit të kurrikulave, metodave të mësimdhënies dhe integritit të tyre me shkencën, duke ofruar mësimin në tre cikle dhe në të gjitha format e studimit sipas procesit të Bolonjës;
- Sigurimi i cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë dhe e programeve të tyre të studimit, përmes kontrollit të brendshëm të cilësisë dhe proceseve të sigurimit të jashtëm të cilësisë;
- Zgjerimi i sistemit të Arsimit të Lartë, nëpërmjet rritjes së pranimeve në programet e studimit ekzistuese, sigurimit të shumëllojshmërisë së ofertave të formimit dhe përmirësimit të skemës dhe efektivitetit të mobilitetit të studentëve;
- Rritja e autonomisë së Institucioneve të Arsimit të Lartë në katër drejtime; akademike, strukturore, administrative dhe financiare.

### **3.6 KËRKIMI SHKENCOR**

#### **Qëllimet e Politikës së Programit:**

- Rritja dhe zgjerimi i kërkimit shkencor në Shqipëri;
- Integrimi me përparësi i kërkimit shkencor shqiptar në Hapësirën Evropiane të Kërkimit ( ERA), nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në Programet Ndërkombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit;
- Përmirësimi i cilësisë dhe orientimi i kërkimit shkencor nga tregu i punës, nëpërmjet forcimit të lidhjeve të Programeve Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kërkimit Shkencor me biznesin privat;
- Hartimi i një kuadri ligjor e institucional për një menaxhimin me cilësor të kërkimit shkencor.

## 4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2010

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas PBA 2010-2012 të gushtit 2009, gjatë vitit 2010 do të ofrojë produktet si më poshtë:

### 4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

**Objektivat e politikës:**

- Menaxhimi me efikasitet i financave për këtë sektor;
- Përafrimi legjislativ kombëtar me atë të BE;
- Decentralizimi i menaxhimit të sistemit në nivel DAR/ZA;
- Zhvillimi profesional i stafit për të rritur kapacitetet, nëpërmjet trajnimeve, konsulentëve, udhëzuesve e procedurave vetëvlerësuese;
- Trajnimi i drejtuesve të shkollave për realizimin e autonomisë shkollë;
- Shtrirja e sistemit të informacionit EMIS në 30% të DAR/ZA.

**Produktet kryesore që do të ofrohen në vitin 2010:**

- Krijimi i kushteve të punës për punonjësit në MASH dhe DAR/ZA me kosto totale 245.2 milion lekë si dhe blerje e 11 pajisjeve e mobilitetit zyrtar me kosto për njësi 1.8 milion lekë;
- 200 punonjës të MASH dhe DAR/ZA të trajnuar me kosto për njësi 210 mijë lekë, si dhe të trajnuar në kuadër të sistemit EMIS me kosto totale 12 milion lekë;
- 450 drejtorë të shkollave të trajnuar me kosto për njësi 84 mijë lekë;
- 38 pajisje dhe mjete informatike dhe elektronike për menaxhimin e MASH dhe DAR/ZA të blera me kosto për njësi 1.75 milion lekë;
- Ndërtime të reja dhe rikonstrukcione për përmirësimin e infrastrukturës në MASH dhe DAR/ZA me kosto totale 32.7 milion lekë si dhe zgjerime të mjediseve me kosto totale 39.2 milion lekë.;

### 4.2 ARSIMI BAZË (PËRFSHIRË PARASHKOLLORIN)

**Objektivat e politikës:**

- Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe përditësimi i kurrikulave në përputhje me standartet evropiane;
- Promovimi i inisiativës kundër varfërisë, për të zvogëluar hendekun në arsimin ndërmjet shtresave të ndryshme të popullsisë;
- Reduktimi me 0,2 % në vit i numrit të nxënësve që braktisin shkollën;
- Sigurimi i financimit për parashkollorët për rritjen e normës së regjistrimit;
- Futja e një gjuhe të dytë të huaj ( duke filluar nga klasa e 6);
- Subvencionimi i teksteve dhe pajisja 100% e nxënësve me tekste shkollë në kohë dhe me cilësi.

**Produktet kryesore që do të ofrohen në vitin 2010:**

- 40 kurrikula të rishikuara dhe të rivlerësuara të arsimit bazë me kosto për njësi 90 mijë lekë;
- 11 mijë mësues të trajnuar për kurrikulat e reja me kosto për njësi 18.4 mijë lekë;
- 480 mijë nxënës që përfitojnë nga botimi i teksteve shkollore, kosto totale 380 miliona lekë;
- 50 tekste të minoriteteve të përkthyer dhe të botuara me kosto për njësi 180 mijë lekë;
- Botimi i teksteve për diasporën me kosto totale 8 milion lekë;
- Hartimi i 10 standarteve për arsimin bazë me kosto për njësi 100 mijë lekë;
- 750 mësues të trajnuar që punojnë me nxënës të shtresave të marginalizuara me kosto për njësi 4600 lekë;
- Shërbimi i transportit për 26 mijë mësues dhe nxënës me kosto për njësi 14 mijë lekë;
- Realizimi i 6 aktiviteteve ekstrakurrikulare me kosto për njësi 1.166 mijë lekë;
- Hartimi dhe dizenjimi i 16 projekteve ndërtimore sipas standardeve me kosto për njësi 3.1 milion lekë;
- Pajisja e 107 laboratorëve kimie, fizike, biologjie me kosto për njësi 3 milion lekë;
- Ndërtimi i 492 klasave të reja sipas parametrave të kërkuar me kosto për njësi 3.8 milion lekë;
- 696 klasa të rehabilituara në arsimin bazë me kosto për njësi 2.3 milion lekë;
- 45 klasa kopshtesh të rehabilituara me kosto për njësi 2.7 milion lekë;
- 2199 klasa shkollash dhe kopshtesh të reja, të rehabilituara dhe të furnizuara me pajisje me kosto për njësi 242 mijë lekë;
- 75 kabinate të informatikës të pajisura me mobileri me kosto për njësi 2.1 milion lekë;
- 233 kabinate të lëndëve kimi, fizikë, biologji të pajisur me mobileri me kosto për njësi 86 mijë lekë;
- 20 grupe kopshtesh të reja të ndërtuara dhe të pajisura me kosto për njësi 6.4 milion lekë.

### 4.3 ARSIMI I MESËM (I PËRGJITHSHËM)

#### Objektivat e politikës:

- Rritja e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet: hartimit të kurrikulave të reja për klasën e 12 dhe trajnimeve të mësuesve për kurrikulat dhe teknikat e reja të mësimdhënies, të aplikuara në vendet e BE;
- Trajnimi i 90% të vlerësuesve të testeve të maturës shtetërore;
- Përmirësimi i standarteve të infrastrukturës në arsimin e mesëm të përgjithshëm, (3% e klasave ndaj totalit ekzistues do të rehabilitohen, 3% e klasave do të ndërtohen të reja dhe 15% e shkollave do të pajisen me laborator shkencor);
- Pasurimi i bibliotekave në të gjitha shkollat;

#### Produktet kryesore që do të ofrohen në vitin 2010:

- 150 Shkolla që aplikojnë në kuadër të decentralizimit dhe autonomisë financiare me kosto për njësi 1 milion lekë;

- 25 hartime kurrikulash të reja, për klasën e 12 të Arsimit të Mesëm të Përgjithshëm me kosto për njësi 120 mijë lekë;
- 4000 mësues të trajnuar, për kurrikulat e reja në gjimnaze dhe zhvillimin profesional me kosto për njësi 14.7 mijë lekë;
- Sigurimi i 59 teksteve shkollore për nxënësit e arsimit të mesëm të përgjithshëm me kosto për njësi 76.3 mijë lekë;
- 30 buletine dhe botime në ndihmë të mësuesve me kosto për njësi 40 mijë lekë;
- 50 veprimtari ekstrakurrikulare në Arsimin e Mesëm të Përgjithshëm me kosto për njësi 24 mijë lekë;
- Furnizimi me pajisje laboratorit kimie, fizike, biologjie për 87 shkolla të mesme të përgjithshme me kosto për njësi 3 milion lekë;
- Ndërtimi i 204 klasave të reja me kosto për njësi 3.9 milion lekë;
- Rehabilitimi dhe zgjerimi i 97 klasave në arsimin e mesëm me kosto për njësi 2.5 milion lekë;
- Pajisje mobilerie të 280 klasave të reja dhe të rehabilituara me kosto për njësi 330 mijë lekë;
- 46 shkolla të pajisura me mobileri për kabinetet e informatikës me kosto për njësi 326 mijë lekë;
- 64 shkolla të pajisura me mobileri për laboratorët kimi fizikë biologji me kosto për njësi 125 mijë lekë;
- 87.300 nxënës përfitojnë nga krijimi i bibliotekave në arsimin e mesëm të përgjithshëm me kosto për njësi 800 lekë.

#### **4.4 ARSIMI I MESËM (PROFESIONAL)**

##### **Objektivat e politikës:**

- Rritja e tërheqjes së nxënësve në arsimin profesional dhe social-kulturor duke zbatuar strukturën 2+1+1, 2+2,4;
- Trajnimi i mësuesve të arsimit profesional;
- Hapje e degëve të reja të TIK në Durrës dhe Elbasan;
- Mbështetje me bursa e nxënësve në profilet bujqësi, veterinar, ndërtim dhe pyje.
- Mbështetje me bursa e nxënësve nga 16 rrethet e vendit (rrethet veri dhe juglindore), që rregjistrohen në arsimin profesional.

##### **Produktet kryesore që do të ofrohen në vitin 2010:**

- Rishikimi i 30 skelet-kurrikulave të kualifikimeve profesionale me kosto për njësi 114 mijë lekë dhe përgatitja e 70 skelet-kurrikulave të reja me kosto për njësi 120 mijë lekë;
- Hartimi i 50 programeve të reja për shkollat tekniko-profesionale dhe social-kulturore, si dhe përmirësimi në bashkëpunim me biznesin i 25 programeve mësimore me kosto për njësi 120 mijë lekë;
- Hartimi i 10 teksteve të integruara për lëndët profesionale me kosto për njësi 250 mijë lekë;
- Trajnimi i 400 mësuesve të arsimit profesional e social-kulturor me kosto për njësi 25 mijë lekë;
- Rritja në 25 780 e numrit të nxënësve në shkollat profesionale e social-kulturore me kosto për njësi 70 mijë lekë;
- 5000 nxënës të motivuar me bursa shteti me kosto për njësi 32 mijë lekë;

- 5 shkolla profesionale të akredituara me kosto për njësi 1 milion lekë;
- 18 klasa të reja të shkollave profesionale + baza prodhuese didaktike me kosto për njësi 3.8 milion lekë;
- Rehabilitimi i 81 klasave, kabineteve dhe bazave prodhuese didaktike të shkollave profesionale me kosto për njësi 2.3 milion lekë;
- Hartimi dhe dizenjimi i 8 projekteve ndërtimore me kosto për njësi 981 mijë lekë;
- Furnizimi i 96 klasave me pajisje mësimore didaktike me kosto për njësi 250 mijë lekë;
- Krijimi 5 laboratorëve të lëndëve profesionale në arsimin e mesëm profesional me kosto për njësi 6 milion lekë;
- Përmirësimi i infrastrukturës së shkollave përmes blerjes së 15 laboratorëve kimi, fizikë, biologji me kosto për njësi 2 milion lekë;
- Blerje pajisje mobilerie për 15 laboratorë në arsimin profesional me kosto për njësi 800 mijë lekë;
- Blerje pajisje për 4 laboratorë, në fuqizim të bazave didaktike mësimore me kosto për njësi 5 milion lekë;
- Rehabilitimi i 35 dhomave të konvikteve ekzistues të arsimit profesional me kosto për njësi 1.6 milion lekë dhe paisja e 34 dhomave dhe kuzhinave me kosto për njësi 441 mijë lekë.

#### 4.5 ARSIMI UNIVERSITAR

##### Objektivat e politikës:

- Të përmirësohet cilësia e mësimdhënies në sistemin e Arsimit të Lartë nëpërmjet a) hapjes së 30 kurrikulave të reja të ciklit të dytë dhe 15 programeve të studimit të ciklit të tretë sipas standarteve europiane b) përmirësimit të metodës së mësimdhënies dhe trajnimit të stafit akademik;
- Të sigurohet cilësia institucionale e programeve të studimit, nëpërmjet a) ngritjes së grupeve të vlerësimit të brendshëm në të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë b) akreditimit institucional të IAL dhe programeve përkatëse të studimit në ciklin e parë me kohë të plotë deri në masën 70%, dhe 20 % të programeve me kohë të pjesshme;
- Të zgjerohet sistemi i Arsimit të Lartë nëpërmjet a) rritjes së kontigjentit të studentëve që ndjekin Arsimin e Lartë publik apo privat me 2% ose rreth 1.500 studentë më shumë se në vitin 2009 b) zgjerimit të mjediseve të IAL, duke rikonstruktuar ndërtesat e vjetra dhe ngritjen e godinave të reja c) shtimit të numrit të studentëve në programet e studimit matematikë, fizikë, informatikë, shkencë inxhinierike nga 13 % në 15% dhe rritjes së numrit me 60-70 pedagogë për këto degë;
- Rritja e autonomisë financiare të IAL.

##### Produktet kryesore që do të ofrohen në vitin 2010:

- 3 struktura të reja të ngritura për trajnimin e mësuesve, kosto për njësi 3 milion lekë;
- 55 kurrikula të reja dhe të ristrukturuara sipas procesit të Bolonjës me kosto për njësi 109 mijë lekë;
- 130 programe CEEPUS (Central European Exchange Program for University Studies) me kosto për njësi 169 mijë lekë;

- 10 institucione të arsimit të lartë të vlerësuara dhe akredituara me kosto për njësi 4.1 milion lekë;
- 100 programe studimi të vlerësuara dhe të akredituara me kosto për njësi 120 mijë lekë;
- 40 vlerësime të grupeve të brendshme dhe të jashtme me kosto për njësi 175 mijë lekë;
- 10 ekspertë evropiane në akreditimin e IAL me kosto për njësi 1 milion lekë;
- 5500 studentë që përfitojnë bursa me kosto për njësi 60 mijë lekë;
- 35 anëtarë të Këshillave të Administrimit të IAL të trajnuar me kosto për njësi 143 mijë lekë;
- 14500 studentë të akomoduar me kosto për njësi 26 mijë lekë;
- 19.000 mijë metër katrorë të rehabilituara në godinat ekzistuese të IAL me kosto për njësi 35 mijë lekë;
- 25 studime dhe projekte për ndërtimin dhe rikonstruktimin e godinave universitare me kosto për njësi 1.6 milion lekë;
- 75 pajisje auditoresh dhe zyra departamentesh në IAL me kosto për njësi 1.6 milion lekë;
- 29 laboratorë mësimore të krijuar me kosto për njësi 9.9 milion lekë;
- 59 laboratorë të informatikës të krijuar me kosto për njësi 1.9 milion lekë;
- 3 universitete që përfitojnë makineri teknologjike për mësimdhënie me kosto për njësi 6.7 milion lekë;
- 6 universitete me rrjet telematik universitar me kosto për njësi 22.5 milion lekë;
- 27 Biblioteka të dixhitalizuara me kosto për njësi 2.1 milion lekë;
- Blerje e 5 mjeteve transporti me kosto për njësi 3 milion lekë.

#### 4.6 KËRKIMI SHKENCOR

##### Objektivat e politikës:

